

Mjeku i familjes dhe pediatri që keni zgjedhur X

Mjeku i familjes apo mjeku i përgjithshëm (MMG) ndjek të gjithë popullsinë nga moshë 14 vjeç e sipër. Gjithsesi, nëse familja dëshiron në moshën nga 6 deri 14 vjeç mund të zgjedhi mes mjekut të familjes dhe pediatrit. Pediatri i zgjedhur, i quajtur edhe Pediatri i familjes, është mjeku i besuar për fëmijët nga moshë 0 deri 14 vjeç dhe mjeku i posaçëm për fëmijët, për moshën e zhvillimit dhe adoleshencën.

Ambulatori i Mjekut të familjes është i hapur pesë ditë në javë, nga e hëna deri të premten. Orari duhet të jetë i ekspozuar në hyrje të zyrës së mjekut. Në rast nevojë apo nën kërkesën e pacientit mjeku i familjes bën vizita shtëpie.

Mjeku, pas vizitës së pacientit, mund të japi udhëzime për mjekim, mund të çoj për vizita tek mjekët specialist, për analiza laboratoriale ose të kërkoj shtrimin në spital.

Për vizita dhe receta urgjente, nëse mjeku i familjes është në bashkëpunim me mjekë të tjerë të familjes (mjeksi grupi, mjeksi në rrjetë) pacienti mund të drejtohet edhe njërit prej mjekëve bashkëpunues.

Në rastet kur mjeku mungon, për sëmundje apo pushime, ka për detyrë të komunikojë pacientëve të tij emrin e mjekut zëvendësues. Për urgjencë nate ose në ditët e festave dhe para festave mund të drejtoheni mjekut të rojes (guardia medica)

Zgjedhja e mjekut të familjes ose pediatrit të besuar X

Rregjistrimi në Shërbimin shëndetsor shtetror, i dokumentuar me kartën shëndetsore, ju jep të drejtën të zgjidhni mjekun e familjes (Mjekun e Mjeksisë së Përgjithëshme MMG) ose Pediatrin e besuar (Pediatri i zgjedhur – PDL). Fëmijët nga 0 deri në 6 vjeç duhet detyrimisht të rregjistrohen tek Pediatri i besuar. Nëse në zonën ku banoni nuk është i pranishëm Pediatri asistencë garantohet nga Mjeku i familjes.

Zgjedhja e mjekut dhe e pediatrit mund të kryhet nga personi në sportelet e Distriktit shëndetsor të zonës së banimit nëpërmjet FSE (Fascicolo Sanitario Elettronico) ose nëpërmjet postës elektronike. Nëse ju duhet të zgjidhni mjekun si pasojë e transferimit nga një bashki në tjetrën në Rajone të ndryshme,

mjafton të paraqisni dëshminë e anulimit të mjekut nga Ausl i mëparshëm.

Revokim i mjekut të familjes dhe pediatrit të besuar X

Në çdo moment mund ta revokoni zgjedhjen e mjekut të familjes apo të pediatrit të besuar. Mjafton ti komunikohet Distriktit Shëndetsor përkatës (AUSL) nga ana e pacientit, ose e përgjegjësit ligjor në rastin e të miturit, ose nga një person zyrtarisht i autorizuar.

Natyrisht, pas revokimit, pacienti duhet të zgjedhi një mjek tjetër për të pasur vazhdimësi në asistencën mjeksore (shiko "Zgjedhja e mjekut")

Zgjedhja e mjekut mund të anulohet edhe në rast transferimi të adresës së pacientit: në këtë rast distrikti i vendbanimit të ri mund të kërkojë një dokument ku deklarohet anulimi.

Në hartën ndërvepruese "Kërko mjekun" mund të gjeni ambulatorët e mjekëve dhe pediatrikëve të Emilia -Romagna: adresat, oraret, numrat e telefonave, ambulatorët sa më pranë banesave, ambulatorët e mjekëve që bashkëpunojnë në grup. "Kërko mjekun" përdor një rrjetë (Sole) të dhënash që lidh të gjithë mjekët e familjes dhe pediatrikët.



(1)



Ndërmjetësim kulturor, informazione të dobishme për qytetarët e huaj.

Ndërmjetësimi kulturor ka si qëllim, nëpërmjet mediatorëve kulturor të kombësive të ndryshme dhe përkthyesve, të ndihmojë qytetarët e huaj në përdorimin e strukturave dhe të shërbimeve shëndetsore duke ofruar mbështetje në procesin e diagnozave dhe të mjekimeve.

Në zona të ndryshme të territorit gjenden sportele aktive të ndërmjetësimit kulturor dhe gjatë gjithë harkut ditor është i gatshëm një shërbim kulturor, me thërritje, si për personat e shtruar (i aktivizuar nga struktura e shtrimit) si për pacientët e ambulatorëve (nën kërkesën e operatorëve)

Në shërbimin kulturor përfshihen, përveç përkthimit të dokumentave klinik edhe përkthime e përhapje të materialeve informuese, në rastet kur nevojitet, dedikuar të huajve.

Në strukturat shëndetsore të vendosura në bregdetin e Romagna-s është i disponueshëm një shërbim përkthimi. Qytetari i huaj mund të drejtohet njërit prej strukturave fikse të Ndërmjetësimit kulturor për të pasur informacionet e duhura në lidhje me procesin mjekësor.

Në rast shtrimi në Spital, Ndërmjetësimi kulturor mund të aktivizohet direkt nga operatorët shëndetsorë, informacione të dobishme në italisht, arabisht, frëngjisht, kineze dhe anglisht

Asistencë shëndetsore për të huajt

Shërbimi Shëndetsor Rajonal i garanton asistencë shëndetsore qytetarëve të huajve të regjistruar në Shërbimin Shëndetsor Shtetëror (Publik) dhe ofron disa shërbime shëndetsore të veçanta edhe për qytetarët emigrant pa lejen e qëndrimit: mjekime ambulatoriale dhe spitalore urgjente (si p.sh. pronto soccorso/urgjenca) e gjithsesi shërbime themelore si në raste sëmundjesh dhe aksidentesh, kujdesim për shtatzaninë dhe lehonën, kujdesim për shëndetin e të miturve, vaksinime, ndërhyrje profilaksie kombëtare, profilaksi për sëmundjet ngjitëse, ndërhyrje të Sert (shërbime mbi vartësinë nga drogat) dhe shërbime të shëndetit mendor.

Regjistrimi në Shërbimin shëndetsor shtetëror është falas.

Duhet ti drejtoheni Sportelit të Distriktit të Ausl (Sportello Unico) të vendqëndrimit me kartën e identitetit, me lejen e qëndrimit (permesso di soggiorno, ose me një dokument ku deklarohet që qytetari është në pritje të rinovimit apo lëshimit të lejes së qëndrimit) dhe me vetvërtetim të vendit ku banoni.

Me regjistrimin dorëzohet edhe karta shëndetsore që ka të njëjtin afat me lejen e qëndrimit (permesso di soggiorno).

Të huajt përkohësisht prezent në Itali (STP) dhe që nuk janë në rregull me hyrjen brenda shtetit dhe me lejen e qëndrimit, pajisen me një fletë të vlefshme (6 muaj) por të rinovueshme deri sa të përfundojë procedura e lëshimit të lejes së qëndrimit. Karta shëndetsore dhe fleta me afat të përkohshëm janë dokumenta personale (mund të përdoren vetëm nga personi përkatës) dhe shërbejnë në rast nevojë shëndetsore (vizita, analiza gjaku e analiza apo shërbime të tjera).

Brenda strukturave mjeksore gjenden edhe shërbime që i dedikohen veçanërisht të huajve, si p.sh. Këshilltorja familjare dhe “Spazio”, një vend i dedikuar grave emigrante dhe fëmijëve të tyre. Në këto struktura, ku gjenden punonjëse ndërkulturore për të ndihmuar me shërbimet dhe marrëdhëniet me personelin shëndetsor, mund të drejtohen edhe qytetarët e huaj pa lejen e qëndrimit.



Rregjistrim në Shërbimin Shëndetsor Kombtar (SSN)

Për të përdorur shërbimet shëndetsore të ofruara nga Shërbimi Shëndetsor Shtetror (SSN), duhet të regjistrohesh në listat e të asistuarve nga AUSL.

Mënyra e regjistrimit dhe dokumentat që duhen paraqitur ndryshojnë në bazë të kategorisë përkatëse:

- qytetarë italian me vendqëndrim (residenza) dhe rezident të rinj të lindur
- qytetarë të Bashkimit Evropian të regjistruar në gjendjen civile të bashkisë në Itali
- persona pa vendbanim të qëndrueshëm (p.sh.: persona që janë të detyruar të lëvizin vazhdimisht për punë)
- qytetarë jashtë Bashkimit Evropian (ekstra komunitar)
- të mitur të huaj të birësuar ose të dhënë në ngarkim apo para-birësim

Në momentin e regjistrimit në S.S.N. kryhet zgjedhja e Mjekut të familjes (MMG) ose e Pediatrit të familjes (PLS) dhe lëshimi i vërtetimit të regjistrimit e zgjedhjes së mjekut

Zgjedhja dhe revokimi i Mjekut dhe Pediatrit

Regjistrimi në Shërbimin shëndetsor shtetror dokumentohet nga Karta Shëndetsore që dërgohet në shtëpi nga Agjencia e të Ardhurave (agenzia delle entrate).

Kodi fiskal dhe karta shëndetsore e Emilia-Romagna

Është i mundur regjistrimi për një periudhë të kufizuar në S.S.N. në AUSL e territorit në të cilin përfshihet bashkia ku

banoni përkohësisht (jo vendqëndrimi/residenza). Rregjistrimi i përkohshëm munda të aktivizohet për arsyet e mëposhtme:

- arsye shëndeti
- arsye pune
- arsye studimi
- arsye familjare
- qëndrim i detyrueshëm apo liri provizore
- papunësi

Ky banim në këtë bashki duhet të zgjasi më shumë se tre muaj dhe regjistrimi në shërbimin shëndetsor në këto raste ka afat minimumi tre muaj e maksimumi një vit dhe në rast kërkesë nga i interesuari mund të rinovohet. Agjencia e të ardhurave e dërgon kartën shëndetsore në adresën e vendqëndrimit edhe pse mund të jetë një tjetër Rajon (regione)

Rregjistrimi në Shërbimin shëndetsor shtetror : dërgimi i kartës shëndetsore

Gëzojnë të drejtën e regjistrimit në Shërbimin shëndetsor shtetëror qytetarët italian me vendqëndrim, të lindurit e rinj vendqëndruar, qytetarët e Bashkimit Evropian me vendqëndrim në Itali, personat pa një vendqëndrim të caktuar, qytetarët jashtë Bashkimit Evropian me leje qëndrimi.

Rregjistrimi në Shërbimin shëndetsor kombtar dokumentohet nga karta shëndetsore e cila dërgohet në shtëpi nga Agjencia e të Ardhurave (agenzia delle entrate)

Tek karta janë të shënuara të dhënat civile të asistuarit dhe kodi fiskal.

Kartën duhet ta paraqisni çdo herë që drejtoheni për shërbime shëndetsore të ofruara nga Shërbimi shëndetsor dhe nëse keni nevojë për shërbime mjeksore në vendet e Bashkimit Evropian. Për informacione në lidhje me kartën shëndetsore personale telefononi në numrin jeshil të Agjencisë së të Ardhurave 800 030 070, drejtohuni sportelit të Distriktit të Azienda Usl të vendqëndrimit ose konsultoni faqen dell'Agencia delle Entrate

Çfarë nevojitet

Karta identitetit, leje qëndrimi për të huajt, autodeklaratë vendbanimi.